



# **UDHËZUES PËR QASJE DERI TE DREJTËSIA EKOLOGJIKE NË REPUBLIKA E MAQEDONISË**

**AVOKATI I POPULLIT  
REPUBLIKA E MAQEDONISË  
DHE MJEDISI JETËSOR**

Qendra për Demokraci Ekologjike – Florozon



Ky udhëzues është pjesë e projektit "Gjelbërimi i drejtësisë maqedonase", qëllimi kryesor i të cilit është përforcimi i kapaciteteve të organizatave qytetare dhe zyrave të Avokatit të Popullit në raport me drejtësinë ekologjike në R. Maqedonisë. Po ashtu, ky udhëzues duhet t'u shërbejë qytetarëve në realizimin (përmbrushjen) e të drejtave të tyre kushtetuese dhe ligjore të garantuara dhe nëpërmjet kësaj të kontribuohet drejt përmirësimit të sundimit të të drejtës si dhe të rritet bashkëpunimi në mes të gjithë faktorëve të prekur në mjedisin jetësor.

Implementues i projektit është  
Qendra për Demokraci Ekologjike –Florozon  
në bashkëpunim me zyrën e Avokatit të Popullit në RM.



rr.Kozle p.n 3a/4b, 1000 Shkup, R. Maqedonisë  
tel/faks: 02/2779 028  
[www.florozon.org.mk](http://www.florozon.org.mk);  
[contact@florozon.org.mk](mailto:contact@florozon.org.mk)

mbështetur finanziarish nga ambasada e  
SHBA dhe Mbretërisë së Norvegjisë



janë në bashkëpunim:



Ky projekt është pjesërisht i mbështetur me grant nga Ambasada e SHBA-ve në Shkup. Mendimet dhe konkluzionet ose rekonditimet e paraqitura në këtë dokument janë të autorit dhe nuk i reflektojnë domosdosh ato të Departmentit të Shtetit dhe norvegjeze Ambasadës së Mbretërisë.

## ÇKA ËSHTË AVOKATI I POPULLIT?

Avokati i Popullit është institucion i pavarur, sovran, profesional dhe i specializuar dhe në kryerjen e funksioneve dhe kompetencave para së gjithash i respekton principet e objektivitetit, paanshmërisë, përgjegjësisë, ndershmërisë, ndërgjegjshmërisë, azhuritetit, shpejtësisë, ekspeditivitetit, paanshmërisë partiake, barazisë në mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të qytetarëve pa dallim gjinie, ngjyre, race, feje e të ngjashme. Avokati i Popullit, punët që janë përgjegjësi e tij i kryen në bazë dhe në kuadër të Kushtetutës dhe Ligjit si dhe akteve ndërkombëtare juridike për liritë dhe të drejtat e njeriut.



## CILI ËSHTË ROLI I AVOKATIT TË POPULLIT?

Avokati i Popullit në esencë i mbron të drejtat kushtetuese dhe ligjore të qytetarëve kur të njëjtat shkelen nga ana e organeve shtetërore, mirëpo veprimi i tij ka rol më të gjerë i cili përbëhet nga përparimi, përsosja dhe përmirësimi i punës së administratës shtetërore si shërbim i qytetarëve me qëllim që në mënyrë më efikase dhe më shpejtë ta realizojnë të drejtën e tyre pa stërvizatje të procedurave administrative dhe duke iu larguar procedurave të panevojshme gjyqësore.

## CILAT JANË KOMPETENCAT E AVOKATIT TË POPULLIT NË MJEDISIN JETËSOR?

Avokati i Popullit në kryerjen e punëve kompetente të tij, ndërmerr veprime dhe masa për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese dhe ligjore të qytetarëve, mes tjerash edhe për **të drejtën për mjedis të shëndoshë e të pastër jetësor** që konsiderohet si një prej të drejtave themelore e rregulluar me Kushtetutë, me ligje dhe me konventat ndërkombëtare dhe marrëveshje të ratifikuara në Republikën e Maqedonisë.

Mbrojtja dhe përparimi i mjedisit jetësor numërohet në mesin e vlerave fondamentale dhe për këtë shkak duhet të jetë pjesë e obligimeve parësore të organeve shtetërore të cilat kanë kompetenca në fushën e mjedisit jetësor.



## **ÇKA ËSHTË PARASHTRESA?**

Parashtresa është formë e ankesës me të cilën komunikojmë me Avokatin e Popullit. Edhe pse në Republikën e Maqedonisë nuk ka formë zyrtare të shkruar për parashtresa, Avokati i Popullit për të zhvilluar procedurë para organeve kompetente dhe institacioneve, nevojitet që t'i ketë këto të dhëna:

- Të dhënat personale të parashtreesit (emri dhe mbiemri, adresa, telefoni etj.);
- T'i përmbajë rrethanat, faktet dhe argumentet mbi të cilat bazohet parashtresa (vendimi, ankesa, përfundimi, vërtetimi, mendimi e të ngjashme);
- Në parashtresë duhet të përmenden edhe organi, gjegjësisht organizata ose personi zyrtar për të cilin ka të bëjë parashtresa dhe akti (vendimi, përfundimi, vërtetimi etj.) me të cilën është shkelur e drejta e parashtreesit dhe të arsyetohet se çfarë mjete juridike ka paraqitur parashtreesi.

## **SI MUND TË BËJ PARASHTRESË?**

Secili qytetar mund ta zgjedh njérën prej këtyre mënyrave për parashtrimin e parashtresës:

- Me shkrim (personalisht ose me anë të postës)
- Me gojë me procesverbal në lokalet e Avokatit të Popullit;
- Me telefon ose telefaks;
- Me postë elektronike



**KUR  
AVOKATI  
I POPULLIT**



## KUR KËRKOHET NDIHMA PREJ AVOKATIT TË POPULLIT?

Ndihmë dhe intervenim prej Avokatit të Popullit mund të kërkojë secili qytetar i Republikës së Maqedonisë dhe i huaj (personalisht ose nëpërmjet përfaqësuesit të tij) kur të vlerësojë se ndonjë e drejtë e tij kushtetuese dhe ligjore i është shkelur me akte ose veprime të organeve të administratës shtetërore dhe organeve tjera dhe organizatave që janë kompetenca publike. Mbrojtja e të drejtës para Avokatit të Popullit mund të kërkohet pasi që më herët qytetari i është drejtuar (ka bërë kërkesë, lutje, ka kërkuar ndihmë, intervenim ose ndonjë veprim tjetër) deri te organi kompetent ose organizata dhe më pastaj ai organ ose organizatë ka sjellë ose nuk ka sjellë akt, ka ndërmarrë, gjegjësisht nuk ka ndërmarrë veprim adekuat. Procedura para Avokatit të Popullit inicohet me parashtrimin e parashtresës (ankesë). Avokati i Popullit mund të ngritë procedurë edhe me vetiniciativë, mirëpo për vazhdimin e procedurës nevojitet pëlqimi i qytetarit të cilit i është shkelur e drejta kushtetuese ose ajo ligjore.



**KU  
AVOKATI  
I POPULLIT**



## PARA CILAVE ORGANE PARAQITET AVOKATI I POPULLIT?

### QEVERISË SË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË:

- shërbimeve;
- komisioneve;
- sekretariateve.

### MINISTRIVE:

#### 1.Organeve shtetërore në përbërje të ministrive:

drejtues, inspektorateve, fondeve, enteve, zyrave, agjencive, shërbimeve, enteve shëndetësore, institucioneve arsimore, qendrave për punë sociale e të tjera.

#### 2.Njësitë rjonale:

Avokati i Popullit intervenon edhe në punën e ndërmarrjeve publike, shërbimeve dhe enteve nga fusha e: postës, telekomunikacioneve, elektroekonomisë, radio dhe televizionit, ndërmarrjeve banesore dhe komunale, hekurudhë si dhe në organet dhe trupat e vetëqeverisjes lokale.



## **KUR MUND TË INTERVENOJË AVOKATI I POPULLIT?**

- Kur janë shkelur të drejtat individuale të qytetarëve me akte ose veprime të organeve drejtuese shtetërore dhe organeve tjera dhe organizatave që kanë kompetenca publike;
- Kur me kërkesë të qytetarëve janë sjellë akte administrative (vendime, përfundime, vërtetime, mendime etj.) me të cilat gabimisht është vërtetuar gjendja faktike, gabimisht është realizuar ligji material, është s'kkelur procedura administrative ose ndonjë procedurë tjetër;
- Kur është vepruar kokë më vete, në mënyrë burokratike, jo të hijshme dhe johumane ndaj qytetarëve;
- Kur nuk është vepruar sipas kërkesave ose është sjellë vendimi në bazë të kërkesës pa bazë ligjore;
- Kur pala dërgohet prej njërit sportel në tjetrin ose prej njërit organ në tjetrin për punë dhe për mbledhjen e dëshmive për të cilat organi zyrtarisht mund të furnizohet.
- Kur nuk përfshihet pala e interesuar në procedurë;
- Kur stërzgjatet procedura pas kërkesës;
- Kur nuk kryhen aktet ekzekutive dhe vendimtare drejtuese dhe kur nuk veprohet sipas udhëzimeve të organeve drejtuese dhe gjyqësore të shkallës së dytë.



## **SI MUND TË NDIHMOJË AVOKATI I POPULLIT?**

Avokati i Popullit pasi që ta pranojë parashtresën dhe pasi që të konstatojë se janë shkelur të drejtat kushtetuese dhe ligjore të parashtruesit të parashtresës ose janë bërë parregullësi të tjera, Avokati mund:

- Të japë rekomandime, propozime, mendime dhe të tregojë për mënyrën e largimit të lëndimeve të konstatuara;
- Të propozojë sërisht të kryhet procedura e caktuar në pajtim me ligjet;
- Të ngritë iniciative për nisjen e procedurës disiplinore kundër personit ligjor, gjegjësisht personit përgjegjës dhe të bëjë kërkesë deri te prokurori kompetent publik për ngritjen e procedurës për vërtetimin e përgjegjësisë me dënim
- Të kërkojë shtyrje kohore të kryerjes së aktit drejtues deri te vendimi i organit të shkallës së dytë ose deri te sjellja e vendimit nga gjyqi kompetent, nëse konstaton shkelje të të drejtës, kurse kryerja e aktit drejtues do të shkaktonte dëm të pakompensueshëm për ndonjëren palë në kontest.



## KUR NUK VEPRON AVOKATI I POPULLIT?

- NËSE PREJ VEPRIMIT OSE PREJ VENDIMIT TË FUNDIT TË ORGANIT, GJEGJËSISHT INSTITUCIONIT KA KALUAR MË SHUMË SE NJË VIT;
- NËSE PREJ TË DHËNAVE QË I KA NË DISKONIM DEL SE NUK BËHET FJALË PËR SHKELJE TË TË DREJTAVE THEMELORE TË NJERIUT;
- NËSE PARASHTRESA NUK ËSHTË E KOMPLETUAR



## SHEMBULLI

Fabrika nga dega e industrisë kimike në mënyrë jo adekuate i trajton mbeturinat nga prodhimi, me çka dukshëm e ndot mjedisin jetësor dhe ndikon dëmshëm në shëndetin e banorëve lokalë. Një grup i banorëve lokalë e lajmërojnë inspektoratin shtetëror për mjedis jetësor me anë të kërkesës për kryerjen e kontrollit inspektues të fabrikës dhe përcaktimin e shkallës së ndotjes në lokalitetin e caktuar. Inspektorati për mjedisin jetësor nuk vepron në bazë të kërkesës së banorëve e as që i informon ata për shkaqet e mosveprimit. Banorët, duke konsideruar se u është shkelur e drejta nga ana e inspektoratit, ata parashtronjë parashresa deri te Avokati i Popullit, i cili pas shqyrtimit të rastit, konstaton shkelje të të drejtës dhe kontaktion me inspektoratin prej të cilit kërkon që i njëjti të veprojë sipas kërkesës së lartpërmendur. Inspektorati për mjedisin jetësor vepron në bazë të kërkesës së Avokatit të Popullit dhe kryen mbikëqyrje inspektuese në fabrikë dhe e përcakton shkallën e ndotjes, në bazë të së cilës parashtron padi penale deri te gjykata kompetente që izrekuna ndalesë kohore për kryerjen e veprimitarës së fabrikës derisa të mos largohen të gjitha vërejtjet e regjistruara nga ana e inspektoratit.



## SI TË KONTAKTOJ ME AVOKATIN E POPULLIT?

Zyra kryesore e Avokatit të Popullit gjendet në Shkup, por gjithashtu ka edhe zyre ragonale në këto qytete: Tetovë, Kërçovë, Shtip, Strumicë, Kumanovë dhe Manastir. Avokati i Popullit në veprimin e tij pas parashtresës gjithmonë e respekton privatësinë dhe fshehtësinë e të dhënave të parashtruesit të parashtresës dhe për ndërmarrjen e një aktiviteti të këtillë, parashtruesi nuk mund dhe nuk guxon të përjetojë pasoja të dëmshme nga organi i cili ia ka shkelur të drejtën. Për parashresën e parashtruar, nuk paguhet takse.

### Informacioni i kontaktit [www.ombudsman.mk](http://www.ombudsman.mk)

#### Shkup:

Tel: 02/ 3129 335

Faks: 02/ 3129 359

[contact@ombudsman.mk](mailto:contact@ombudsman.mk)  
rr.Dimitrie Cupovski bb

#### Tetovë:

Tel: 044/ 228 585

Faks: 044/ 344 083

[contact@ombudsman.mk](mailto:contact@ombudsman.mk)  
rr.Ilindenska br.85

#### Kërçovë:

Tel: 045/ 228 586

Faks: 045/ 228 584

[contact@ombudsman.mk](mailto:contact@ombudsman.mk)  
rr.Bul.Osloboduvanje bb

#### Shtip:

Tel: 032/389 700

Faks: 032/389 701

[contact@ombudsman.mk](mailto:contact@ombudsman.mk)  
rr.Tosho Arsov bb

#### Strumicë:

Tel: 034/329 996

Faks: 034/329 997

[contact@ombudsman.mk](mailto:contact@ombudsman.mk)  
rr.Marshal Tito bb.

#### Kumanovë:

Tel: 031/431 520

Faks: 031/ 431 520

[contact@ombudsman.mk](mailto:contact@ombudsman.mk)  
rr.Trg Nova Jugoslavija 24

#### Manastir:

Tel: 047/ 242 310

Faks: 047/ 242 510

[contact@ombudsman.mk](mailto:contact@ombudsman.mk)  
rr.Jane Sanadanski bb.

në **Avokati i Popullit**  
rr.Dimitrie Çupovski p.n 2, 1000 Shkup, R. Maqedonisë

## **PARASHTRESË**

emri mbiemri

adresa

vendbanim

kod postar

mosha

gjinia  M  f

shtetësia

profesioni

organi apo organizata me të cilën ka të bëjë parashtresa

emri, mbiemri dhe funksioni i personit zyrtar i cili ka bërë shkelje të të drejtës se parashtruesit

A e keni kontakti institucioni kompetent për problemet që pasoi që bazuar në një parashtresa?

po  jo

ne vazhdim jepni te dhena per aktin (vendimin, perfundimin etj) me te cilin u eshte shkelur e drejta ose beni pershkrimin e veprimit me te cilin u eshte bere shkelja e te drejtave

në vazhdim tregoni se ç'mjete juridike keni shfrytëzuar(cilit organ dhe kur i jeni drejtuar)

të dhëna të favorshime: dëshimi

në zyrën e advokatit të popullit më pranoi personi zyrtar

data

parashtruesi